



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1740 Prot.

Tiranë, më datë 20.12.2021

VENDIM  
Nr. 704, datë 20.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, ndryshuar me Vendim Nr. 329, datë 02.06.2021, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 20.12.2021:

VENDOSI:

- Miratimin e kërkesës së Znj. Edlira Çausi për pajisje me Licencë individuale në mbikëqyrje-kolaudim (MK), në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale për kategorinë (V), në nënkategoritë
  - MK/V/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;
  - MK/V/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
  - MK/V/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;
  - MK/V/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim të veprave të artit në metal, qelq.
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
- Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

